

# Provimi 1

**Pjesa A: Pyetje me zgjidhje shumëfishe, vetëm njëra nga përgjigjet është e saktë. Secila përgjigje e saktë 2 pikë (gjithsej 20 pikë)**

1. Qëllimi primar i kontabilitetit është të
  - a. **ndihmojë njerëzit të marrin vendim për aktivitetet ekonomike**
  - b. ofroj informata të cilat mund t'i shfrytëzoj menaxhmenti për t'i bindur aksionarët se menaxhmenti meriton paga të larta
  - c. ofroj punësim personave që kanë aftësi të merren me numrat
  - d. minimizoj shumën e fitimit që ka fituar kompania
  
2. Cila nga të mëposhtmet është aktivitet finacues?
  - a. janë blerë stoqet me afat pagese për t'i rishitur
  - b. janë blerë pajisje për përdorim të kompanisë me para të gatshme
  - c. janë paguar rrogat e punonjësve me para të gatshme
  - d. **është marrë një kredi nga banka**
  
3. Cila nga llogaritë e mëposhtme është detyrim?
  - a. shpenzimi i interesit
  - b. **interesi i pagueshëm**
  - c. të hyrat nga interesi
  - d. interesi i arkëtueshëm
  
4. Në shumicën e situatave, të hyrat njihen kur
  - a. paraja është pranuar
  - b. mallrat ose shërbimet janë blerë
  - c. konsumatorët kanë porositur
  - d. **mallrat ose shërbimet janë shitur**

5. Gjatë dhjetorit, pesë punëtorë ishin punësuar. Secili nga ata fitoj nga €2,600 për muaj. Me 31 dhjetor, shumica e këtyre pagave u pagua por mbeti një pjesë për t'u paguar gjatë janarit. Në cilën (at) pasqyrë(a) financiare në fund të vitit do të paraqiten këto fakte??

Bilanci i gjendjes                      Pasqyra e të ardhurave

<b>a.</b>	<b>Po</b>	<b>Po</b>
b.	Po	Jo
c.	Jo	Po
d.	Jo	Jo

6. Një kompani viti fiskal i të cilës përfundon me 31 dhjetor, ka blerë një polisë sigurimi 6-mujore me 1 nëntor. Cila pjesë e shpenzimit të sigurimit duhet të paraqitet si shpenzim për vitin që përfundon me 31 dhjetor?

- a. Asnjëra
- b. 2/6**
- c. 4/6
- d. 2/12

7. Cila nga thënjet e mëposhtme më së miri e përshkruan qëllimin e bilancit të gjendjes?

- a. përmbledhë të hyrat dhe shpenzimet e një periudhe të kontabilitetit
- b. raporton hyrjet dhe daljet e parasë së gatshme
- c. I balancon të hyrat e periudhës së tanishme me të hyrat e periudhës së mëparshme
- d. raporton pasuritë, detyrimet dhe ekuitetin e pronarëve në një datë të specifike**

8. Stoqet duhet të klasifikohen në bilacin e gjendjes si

- a. pasuri qarkulluese**
- b. ekuitet i pronarëve
- c. pasuri jo-qarkulluese
- d. pasuri e paprekshme (e patrupëzuar)
- e. detyrim afatgjatë

9. Cilën nga elementet duhet ta dimë në mënyrë që të përcaktojmë kapitalin qarkulluese të kompanisë?

Pasuritë qarkulluese                      Detyrimet afatshkurta

<b>a.</b>	<b>Po</b>	<b>Po</b>
b.	Po	Jo
c.	Jo	Po
d.	Jo	Jo

10. cila nga të mëposhtmet do të ndikojë në kapitalin e kontribuar të kompanisë?

- a. shitja e aksioneve**
- b. të fituarit e fitimit neto
- c. pagesa e dividendës
- d. blerja e aksioneve të një kompanie tjetër

**Pjesa B: Pyetje: E saktë / E pasaktë – 2 pikë secila (gjithsej 10 pikë)**

1. Nëse firma dështon të regjistroj një shpenzim akrual, atëherë fitimi neto dhe detyrimet do të nënvlerësohen.
  - E saktë
  - E pasaktë**
2. Kosto e ndërtesave zakonisht paraqitet si shpenzim në vitin e blerjes.
  - E saktë
  - E pasaktë**
3. Ditari është regjistër kronologjik i transaksioneve.
  - E saktë**
  - E pasaktë
4. Pasqyrat financiare krahasuese raportojnë aktivitetet e kombinuara të dy apo më shumë korporatave që zotërohen nga të njëjtit aksionarë.
  - E saktë
  - E pasaktë**
5. Dy pjesët kryesore të ekuitetit të pronarëve janë kapitali i kontribuar dhe fitimet e mbajtura.
  - E saktë**
  - E pasaktë

**Pjesa C: Pyetje me zgjidhje shumëfishe – me llogaritje, 5 pikë secila (gjithsej 10 pikë)**

1. Revista Kosovarja ka shitur abonim (parapagim) 5 vjeçar gjatë vitit 2004 në vlerë prej €75,000. Supozoni se të gjitha abonimet fillojnë me 1 janar 2004 dhe viti kalendarik është vit fiskal (I kkontabilitetit). Me 31 dhjetor 2004, cila nga të mëposhtmet duhet të raportohet në pasqyrat financiare të Kosovares?
  - a. të hyra prej €75,000 dhe pasuri prej €75,000
  - b. të hyra prej €15,000 dhe ekuitet prej €60,000
  - c. të hyra prej €15,000 dhe detyrime prej €60,000**
  - d. të hyra prej €15,000 dhe pasuri prej €60,000
2. Kompania Alfa raporton informatat në vijim:

Llogari të pagueshme	€ 600	Llogari të arkëtueshme	€ 5,200
<b>Para</b>	<b>7,000</b>	Kredia nga banka	4,400
Fitime të mbajtura	7,800	<b>Stoqet</b>	<b>10,200</b>
Ndërtesa	17,600	Shpenzime të zyrës	1,600

Cila është shuma e pasurive qarkulluese të kompanisë?

- a. €41,600
- b. €24,000
- c. €22,400**
- d. €13,800

**Pjesa D: Probleme (gjithsej 60 pikë)**

1. Kompania ABA ka pasur transaksionet në vijim gjatë muajit të tetorit, muaji i parë i aktivitetit të kompanisë: **(20 pikë)**

- 1. Pronarët kanë investuar €50,000 para në biznes.
- 2. €1,600 janë paguar për qiranë e zyrës për një muaj.
- 3. Është blerë një pajisje me afat pagese në vlerë prej €6,000.
- 4. Janë kryer shërbime për konsumatorët në vlerë prej €4,000 me para të gatshme.
- 5. Janë kryer shërbime për konsumatorët në vlerë prej €8,000 me afat pagese.
- 6. Është paguar pjesërisht borxhi prej €2,000 për transaksionin nr. 3.

**Kërkohet:**

Pas këtyre transaksioneve, sa është totali i:

- a. Pasurive **64,400**
- b. Detyrimeve **4,000**
- c. Ekuitetit të pronarëve **50,000 + 10,400**
- d. Fitimit neto **10,400**

	PASURIA	DETYRIMET	EKUITETI	+ TE HYRAT	-SHPENZIMET
1	+50000		+50000		
2	-1600				-1600
3	+6000	+6000			
4	+4000			+4000	
5	+8000			+8000	
6	-2000	-2000			
	<b>64,400</b>	<b>4,000</b>	<b>50,000</b>	12,000	-1,600
				<b>FITIMI</b>	<b>10,400</b>

2. Për secilën nga llogaritë në vijim, tregoni nëse **debita** do të rritë apo zvogëlojë tepricën (saldon) në llogari: **(10 pikë)**

<u>Llogaria</u>	<u>E rritë/e zvogëlon</u>
Ekuiteti i pronarëve	<b>E ZVOGELON</b>
Pajisjet	<b>I RRITE</b>
Llogari të pagueshme	<b>E ZVOGELON</b>
Paraja	<b>E RRITE</b>
Të hyrat nga shitja	<b>I ZVOGELON</b>

3. Kompania Fifi ka në dispozicion informatat në vijim me 31 dhjetor 2010: **(30 pikë)**

Kosto e mallit të shitur	€12,000	Paraja e paguar për stoqe	€10,800
Interesi i pagueshëm	1,600	Ndërtesat	40,000
Paraja e paguar për paga	6,000	Shpenzimet tjera	12,400
Sigurimi i parapaguar	400	Llogaria e pagueshme	3,800
Paraja e pranuar nga konsumatorët	20,000	Paraja e paguar për interes	1,340
Shpenzimi i zhvlerësimit	2,400	Aksionet e zakonshme	23,400
Llogaria e arkëtueshme	4,000	Paraja	6,000
Të hyrat nga shitja	33,200	Fitimet e mbajtura	21,600

**Kërkohet:**

Përgatitni një pasqyrë të të ardhurave dhe një bilanc të gjendjes në një format të mirë.

FIFI  
PASQYRA E TW ARDHURAVE  
Pwr vitin qw pwrfundon me 31 dhjetor2010

Tw hyrat	33,200
KMSh	<u>(12,000)</u>
Fitimi bruto	21,200
Shpenzimet operative	
Shpenzimet tjera	12,400
Shpenzimet e zhvlerësimit	<u>2,400</u>
Gjithsej shpenzime	14,800
Fitimi	<u>6,400</u>

FIFI  
BILANCI I GJENDJES  
Me 31 dhjetor2010

**PASURIA**

**Pasuria qarkulluese**

Paraja	6,000
Llogari tw arkwtueshme	4,000
Sigurimi I parapaguar	400
<b>Gjithsej pas qarkulluese</b>	<b>10,400</b>

**Pasuri jo-qarkulluese**

Ndwrtesat	40,000
-----------	--------

**GJITHSEJ PASURIA** **50,400**

**DETYRIMET**

Detyrimet afatshkurta	
Llogari tw pagueshme	3,800
Interesi I pagueshwm	1,600
<b>Gjithsej det afshkurta</b>	<b>5,400</b>

**EKUITETI**

Aksione tw zakonshme	23,400
Fitimet e mbajtura	21,600
Gjithsej ekuiteti	45,000

**EKUITETI DHE DETYRIMET** **50,400**

